

## AKT THEMELIMI

### I SHOQËRISË "MIND MAKERS ALBANIA" Sh.p.k.

Sot, me datë 03.07.2024,

**Z. Andi Memo**, shtetas Shqiptar, lindur më 24.02.1990, në Tirane, Shqiperi, mbajtëse i kartes ID me nr.J00224070A, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

**Znj. Ledina Hoxha**, shtetas Shqiptar, lindur më 28.07.1986 ne Lushnje ,Shqiperi, mbajtëse ID me nr. 165728022R , madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligji nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**Mind Makers Albania**". (më poshtë referuar si "Shoqëria").

#### NENI 1

#### EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**MIND MAKERS ALBANIA**" Sh.p.k.

#### NENI 2

#### SELIA


Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresen: Rruga e Kavajes, Kompleksi Square 21, Shkalla 2, Apartamenti 3,Tiranë, Shqipëri.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjeter.

#### NENI 3

#### KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.



## NENI 4

### OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Edukimin e femijeve sipas programeve ekstra kurrikulare

## NENI 5

### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 800.000 lekë dhe është i ndarë në 2 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Andi Memo**, zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 400.000 Leke të kapitalit themeltar.
- **Znj. Ledina Hoxha**, zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 400.000 Leke të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## NENI 6

### ORGANET E SHOQËRISË


Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjisacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm i shoqërisë është **Znj. Ledina Hoxha**, shtetas Shqiptar, lindur më 28.07.1986, në Lushnje, Shqiperi, mbajtëse i kartes ID me nr.I65728022R , madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar,i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## NENI 7

### LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.



**NENI 8****DISPOZITA FINALE**

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje originale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Akitit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë duke autorizuar është **Znj. Ledina Hoxha**, shtetas Shqiptar, lindur më 28.07.1986, në Lushnje, Shqiperi, mbajtëse i kartes ID me nr. I65728022R, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

**ORTAKËT THEMELUES****ZANDI MEMO**

Angi Memo  


**Znj.LEDINA HOXHA**

Ledina Hoxha  
